

VENDIM
Nr.352, datë 4.5.2011

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004, 2008, 2010, PËR
PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010, për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004,
2008, 2010 PËR PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë: në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar notës verbale 471/04 të datës 21 dhjetor 2004 dhe protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 7 tetor 2008 dhe të datës 18 maj 2010,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat e mëposhtme për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”:

1. Një hua me vlerë prej gjithsej deri në 3 400 000 euro (me fjalë: tre milionë e katërqind mijë euro) nga miratimi i vitit 2004, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur;

2. Një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit me vlerë prej gjithsej deri në 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro) nga miratimi i vitit 2010;

3. Disa shuma financimi me vlerë prej gjithsej 7 400 000 euro (me fjalë: shtatë milionë e

katërqind mijë euro) për projektin, me:

a) deri në 3 000 000 euro (me fjalë: tre milionë euro) nga miratimi i vitit 2008;

b) deri në 4 400 000 euro (me fjalë: katër milionë e katërqind mijë euro) nga miratimi i vitit 2010, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Në mirëkuptim midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4) Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 të pikës 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Miratimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 bëhet i pavlefshëm, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk do të jenë lidhur brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të miratimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2012. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 3a, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016. Për shumat e përmendura në nenin 1, paragrafi 1, pikat 2 dhe 3b, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, i garanton Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, i garanton Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me lidhjen dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e ka njoftuar Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet e brendshme për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më..... në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.